

HR Academy from BPB

BPB

Junior Program

Gjenerata e 10–të

Trajnim profesional
Përvojë praktike
Mbështetje financiare

Të mësuarit nuk përfundon me diplomim!

Banka për Biznes (BPB), përmes Junior Program, ofron mundësi të angazhimit të të rinjve në trajnim dhe përgatitje profesionale nga stafi i bankës për 3 muaj në mënyrën më të mirë për të filluar karrierën tuaj. Programi do të zhvillohet në 'HR Academy from BPB' në Prishtinë nga stafi i bankës, duke kaluar në një seri modulesh që përqendrohen në aftësi të buta dhe profesionale përmes hulumtimeve dhe praktikave më të fundit.

Një pjesë kryesore e programit është rotacioni në departamente dhe degë të ndryshme të BPB-së në qytete të ndryshme të Kosovës, ku përmes punës individuale dhe në ekipe, kandidatët do të njihen me tregjet financiare, operacionet e përditshme dhe projektet reale. Përgjatë gjithë programit, secili pjesëmarrës do të përfitojë mentorim të vazhdueshëm, mbështetje financiare mujore dhe mundësinë për të krijuar një rrjet të gjerë kolegësh.



Nga njohuritë akademike te përvoja reale.

Ne mirëpresim në mënyrë aktive aplikantë me kualifikime të ndryshme, si studentë të vitit të fundit dhe të diplomuar rishtazi (nga fusha si financa, teknologjia, matematika financiare, juridiku, shkencat sociale dhe fusha të tjera studimi). Ky program iu mundëson kalimin nga njohuritë akademike në një përvojë reale profesionale. Ne po kërkojmë studentë që krenohen me aftësinë e tyre për të bashkëpunuar me të tjerët, fokus për t'u përmirësuar, dhe dëshirë të theksuar për të mësuar. Aftësia për të punuar në një mjedis me ritëm të shpejtë, por gjithsesi për të propozuar zgjidhje të menduara për problemet është thelbësore. Ne duam njerëz që i shohin sfidat si mundësi dhe kanë dëshirë të rriten dhe të zhvillohen.

Në përfundim, programi përmbyllet me një ceremoni diplomimi, pajisjen me certifikatë zyrtare dhe një workshop të veçantë që hap mundësi reale për praktikë dhe punësim afatgjatë në BPB.



Modulet e programit

Një pasqyrë e plotë e rrugëtimit tuaj 3-mujor përmes moduleve teorike, sesioneve praktike dhe aktiviteteve ndërvepruese:

01 Orientimi Strategjik & Makroekonomia

02 Operacionet dhe Shërbimet Bankare

03 Financat & Menaxhimi i Riskut Kreditor

04 Pjesa Praktike & Aktivitetet

Vizita tek klientët e Bankës, film me tematikë biznesore dhe prezantimet e projekteve nga studentët.

- **Degët e Bankës**
- **Vizitë në Bankën Qendrore të Kosovës**

Kriteret e pranimit në program



01

Të rinj të moshës 20–29 vjeç, nga të gjitha qytetet e Kosovës.

02

Studentë të vitit të fundit ose të diplomuar rishtazi në Ekonomi, Matematikë Financiare, Teknologji të Informacionit (IT), Juridik, Shkenca Sociale dhe fusha të tjera të studimit;

03

Kandidatë me aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi;

04

Kandidatë me njohuri të mira të gjuhës angleze.

Procesi i aplikimit dhe përzgjedhjes

Për tu bërë pjesë e programit Junior, ju duhet të kaloni në hapat e mëposhtëm:

01 / Aplikimi Online

Duhet të mbushni formularin e aplikimit duke na treguar për çdo aftësi tuajën dhe eksperiencë pune, praktikë apo anëtarësime.

02 / Testimi Logjik

Testimi logjik mat aftësinë tuaj për të interpretuar të dhëna të strukturuara, raporte dhe informacione të ndryshme. Gjithashtu, ai vlerëson procesin tuaj të mendimit, mënyrën e arsyetimit dhe reagimet tuaja ndaj skenarëve të ndryshëm të punës.

03 / Intervista Grupore

Thjesht qëndro vetja! Ne vërtetë dëshirojmë t'ju njohim, prandaj është më mirë të jeni sa më natyral dhe të diskutoni lidhur me tema të ndryshme në grup.

04 / Intervista Individuale

Përzgjedhja në fazat e mëparshme ju dërgon në hapin e radhës: takimin me ekipin tonë. Kjo është mundësia ideale që ne të njohim entuziazmin dhe dëshirën tuaj për t'u rritur.

Zhvillo potencialin tënd. Fito përvojë. Fillo karrierën me BPB.